



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçante



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201400784/4

Tiranë ___/___/2014

Lënda: *Rekomandojmë shpejtimin e procedurave gjyqësore në gjykimin e çështjes penale Nr.463 akti, datë 11.06.2013 ndaj të pandehurëve E. Z. etj.*

Drejtuar : **Z. Skënder HALUCI**
Kryetar i Gjykatës Rrethit Gjyqësor

VLORË

Për dijëni : **Zj.Marsela XHAFERLLARI**
K/Inspektore e KLD-së

TIRANË

I nderuar zoti Kryetar,

Në ankesën e tij datë 22.04.2014 drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit, shtetasi A.L. nga Fshati Llakadund, i rrethit Vlorë, ankohet për zvarritje gjykimi pa shkaqe ligjore dhe shkeljen e procedurave gjyqësore nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, në çështjen penale me Nr.463 akti, datë 11.06.2013 me të pandehur E. Z., F. H., R. Rr. të akuzuar për krimin e vrasjes me dashje në bashkëpunim të djalit tij viktimës L. L. me datë 29.07.2012.

Ankuesi Avni Latifaj pretendon se 1 vit pas ngjarjes dosja ka qëndruar për hetime në Organin e Prokurorisë Rrethit Vlorë, dhe ka 1 vit që dosja është dërguar për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, dhe se shumica e seancave gjyqësore janë shtyrë me kërkesë të avokatëve mbrojtës të pandehurëve ose nuk paraqiten avokatët mbrojtës të pandehurve në gjykim apo nuk paraqiten dëshmitarët e kërkuara nga avokatët mbrojtës.

Nga verifikimi i kryer nga ana jonë rezultoi se për gjykimin e kësaj çështje penale nga Gjykata janë zhvilluar gjithsej 14 seanca gjyqësore dhe në shumicën e rasteve seancat gjyqësore janë shtyrë ose me kërkesën e avokatit mbrojtës ose se nuk paraqiten në seancë gjyqësore avokatët mbrojtës, ose nuk paraqiten në gjyq dëshmitarët e thirrur nga gjykata, etj.

Në nenin 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, parashikohet se: "Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cënohen pa një proces të rregullt ligjor".

"Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjore, ose në rastin e akuzuave të ngritur kundër tij, ka të drejtën e një gjykimit të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj".

Në nenin 2 të Kodit Procedurës Penale, përcaktohet shprehimisht respektimi i normave proceduriale, dhe thuhet se: "Dispozitat proceduriale

caktojnë rregullat për mënyrën e ushtrimit të ndjekjes penale, të hetimit dhe të gjykimit të veprave penale, si dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore. Këto rregulla janë të detyrueshme për subjektet e procedimit penal, për organet shtetërore, personat juridikë dhe shtetasit”.

Nga verifikimi ynë rezultoi se nga gjykata në rastin konkret janë zhvilluar 14 seanca gjyqësore dhe duke analizuar shkaqet e shtyrjes tyre në rreth 50 % të seancave gjyqësore ato janë shtyrë me kërkesë të avokatëve mbrojtës të pandehurëve ose se nuk janë paraqitur fare në gjyq avokatët mbrojtës të cilët janë të interesuar të kalojnë afatet e paraburgimit dhe të pëfitojnë nga ligji klientët e tyre. Në rastin konkret mendojmë se Gjykata duhet të marrë masa organizative dhe ligjore që njoftimi palëve të bëhet në kohë dhe të marrin masa që subjektet të marrin pjesë në procesin gjyqësor.

Duke analizuar datën e ndodhjes së ngjarjes së vrasjes së viktimës L. L. me datën 29.07.2012 e deri më sot kanë kaluar rreth 2 vjet dhe akoma nga gjykata nuk është dhënë një vendim gjyqësor.

E drejta për tu gjykuar para një gjykate kompetente të pavarur dhe të paanshme të caktuar me ligj kërkon që drejtësia jo vetëm të bëhet por ajo të shikohet se po bëhet. Edhe Gjykata Europiane mbi të Drejtat e Njeriut, dhe Gjykata Kushtetuese në vendin tonë në disa vendime të tyre kanë deklaruar se: **”Drejtësia e vonuar është drejtësi e mohuar”**, për rrjedhojë çmohet që në rastin konkret të ndërhyhet me rekomandim për shpejtimin e procedurave gjyqësore.

Kështu, në nenin 63 pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, parashikohet se: **”Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave të njeriut, nga administrata publike”**, dhe të nenit 25 të Ligjit nr.8454 datë 04.02.1999”Për Avokatin e Popullit”, thuhet se: **”Avokati i Popullit pranon ankesa, kërkesa apo njoftime për shkeljen e të drejtave të njeriut, që rrjedhin nga administrata e pushtetit gjyqësor, vendimet e formës së prerë dhe procedurat gjyqësore”**. Hetimi dhe kërkesa e Avokatit të Popullit nuk prekin pavarësinë e gjykatës në marrjen e vendimit.

Për sa sipër, Ju

REKOMANDOJMË :

1. Të merren masa organizative dhe ligjore nga ana juaj për shpejtimin e procedurave gjyqësore në gjykimin dhe përfundimin e kësaj çështje penale me të pandehur E. Z. etj në të ardhmen.

2. Mbi qëndrimin dhe masat e marra nga ana juaj në lidhje me këtë rekomandim, lutemi na njoftoni me shkrim brenda afatit 30 ditor.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONERI

Arben SHKËMBI